

Në tekstet shkollore të nxënësve shqiptarë në Luginën e Preshevës, ku flitet për historinë dhe origjinën e shqiptarëve në Ballkan, shpjegohet qartë se janë të lashtë dhe autokton. Ndërsa për serbë thuhet se janë të ardhur.

Në fakt nëse prisni që libri të ketë si autorë shqiptarë gaboheni, pasi hartuesi i këtij teksti është pikërisht një historian serb (Rade Mihaljčić) dhe libri është shtypur nga Instituti për tekstet në Beograd.

Në këtë tekst shkollohet shkruhet: “Shqiptarët janë popull i lashtë dhe autokton në Ballkan, kurse serbët janë të ardhur nga lindja...”. Dhe kjo fjali ka bërë nervozë disa historianë dhe

media serbe, të cilët librin e autorit serb Mihaljçiç e kanë konsideruar “skandaloz”

(“Slandaložno: Srpski udÅ¼benik iz istorije: Albanci su starosedeooci a Srbi došljaci na

Balkan!”) dhe ky libër i historisë serbe për klasat e gjashta ka ngjallur reagime dhe polemika të

ashpra, shkruan agjencia e lajmeve “Presheva jonë”.

Me kalimin e kohës, duket se edhe vetë serbët po binden gradualisht me realitetin historike,

pavarësisht se disa ende nuk pajtohen me faktin se janë popull i ardhur në Ballkan. Më

konkretisht, autori Mihaljçiç ka shkruar se serbët janë me prejardhje nga vendet e lindjes.

Për këtë ka reaguar prof. Slobodan Antoniç me një shkrim me titull “Vetëurriesit”, duke

akuzuar autorin herë tradhtar e herë mosnjohjes i mirë i historisë. “Autori serb është marrë në

këtë tekst shkollor më shumë me politikën ditore se sa me ‘të vërtetën historike’”.

Antoniç duke kritikuar autorin e njohur serb për tekstet shkollore nënvizon: “Pas leximit të këtij

libri, që unë nuk jam i sigurt, meqë e di mirë historinë mesjetare serbe. E gjithë kjo nuk është e

qartë mjaftueshëm për akademik individual serb siç është rasti me Mihaljin. Kush kujdeset për

hartën e Evropës nga 814 vit në të cilën ajo është e qartë për shtetin serb në Ballkan e cila

kufizohet me Armeninë dhe Azerbajxhanin dhe tani nuk mund të kuptojnë këtë deklaratë në

tekstin mësimor për klasën e gjashtë". /Indeksonline/